



LAJME nga FONDACIONI
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË
Tiranë

Redaksia "ZKM ALBANIA"
Kompleksi Spitalor Universitar
"Zoja e Këshillit të Mirë"
Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë

N.18
Qershor
2025

unikzkm
unikzkm
www.unizkm.al
pr@fzkm.org

MJEKËT E SË NËSËRMES TË TRAJNUAR PËR IA

Algor-etika

Sipas Jonathan H. Chen drejtor për edukimin mjekësor nëpërmjet Inteligjencës artificiale pranë Stanford University School of Medicine, deri disa vite më parë gjysma e mjekëve nuk e dinte çfarë ishte një chatbot. Sot panorama ka ndryshuar rrënjësisht. Shkollat mjekësore nuk mjaftohen më vetëm me shqetësimin për Inteligjencën Artificiale, por po e integrojnë atë në mënyrë aktive në programet e tyre të studimit duke u mësuar studentëve si ta përdorin në mënyrë të përgjegjshme për kujdesin ndaj pacientëve dhe për kërkimin shkencor.

Çdo ditë e më shumë IA-ja po bëhet një mjet i zakonshëm për të ndihmuar mjekët në diagnostikimin dhe trajtimin e pacientëve. Shembuj të përdorimit të saj përfshijnë përmirësimin e imazherisë radiografike, ekzaminimin e mostrave të gjakut, analizën për parashikimin e komplikimeve të plagëve dhe aplikimin e gjenetikës së pacientëve. Çështja është se si t'i përgatisim studentët për një teknologji që mund të tronditë praktikën klinike, por që gjithashtu mund të përmirësojë arsyetimin klinik nëse përdoret në mënyrë efektive.

Qasja ndaj edukimit për IA-në në shkollat mjekësore do të thotë se shumica e studentëve e kanë përdorur atë deri në një farë mase, shpesh për detyrat e universitetit, por pa pasur trajnim formal. Në fakt disa studime kanë zbuluar se deri në 86% e studentëve të universitetit e kanë përdorur Inteligjencën Artificiale për detyrat e shkollës. Ky tregues nënkupton se brezi i ri i studentëve të mjekësisë është tashmë «ekspert në inteligjencën artificiale gjenerative» dhe që pritshmëritë e tyre madje kanë tejkaluar vetë zhvillimin e fakulteteve dhe implementimin strategjik.



nga PADRE PAOLO BENANTI

Këshilltar i Papa Françeskut për çështjet që lidhen me inteligjencën artificiale dhe etikën e teknologjisë //

Anëtar italian i Komitetit për Inteligjencën Artificiale të Kombeve të Bashkuara

Nismat arsimore janë të ndryshme dhe zhvillohen gjatë viteve të studimit duke variuar nga leksionet deri te praktikat më të thelluara. Ato përfshijnë tema themelore si funksionimi i IA-së gjenerative, strategjitë për krijimin e komandave efektive për të marrë përgjigje të dobishme, etika në përdorimin e IA-së (si të mos shpërndahen të dhënat personale të pacientëve), rreziqet (p.sh, përgjigjet e pasakta) dhe rëndësia thelbësore e elementit njerëzor duke përdorur IA-në si një faktor në procesin vendimmarrës, por jo duke i besuar si autoriteti absolut.

Qëllimi nuk është të zëvendësohen funksionet bazë të një mjeku me IA-në, por të ndihmohen profesionistët të jenë më efikase dhe të përmirësohet cilësia e kujdesit ndaj pacientit. Algor-etika na kujton se integrimi i IA-së në edukimin mjekësor nuk është më një opsion, por një nevojë e domosdoshme për të formuar mjekët e së nesërme duke respektuar dinjitetin e pacientëve.



KTHEHET SUMMER SCHOOL NË TIRANË

Dhjetë vjet
dialog për
paqen: 2-9
shtator
2025

Edhe këtë vit rikthehet takimi i Summer School “Root of War & Establishment of a Lasting Peace”, i cili është shënon edicionin e dhjetë. Shkolla e organizuar nga **Qendra Evropiane për Shkencën e Paqes, Integritetit dhe Bashkëpunimit (CESPIC)** pranë UKZKM, tashmë përfaqëson një pikë reference për ata që duan të thellojnë njohuritë mbi shkaqet e konflikteve dhe kushtet e nevojshme për ndërtimin e paqes.

Drejtuar studentëve universitarë dhe doktorantëve Summer School ofron një mundësi konkrete për të trajtuar çështjet e mëdha lidhur me luftën dhe paqen duke adoptuar një qasje të hapur dhe multidisiplinare. Nisma na fton të lexojmë



në mënyrë kritike transformimet që po ndodhin dhe të reflektojmë mbi kushtet që bëjnë të mundur një bashkëjetesë paqësore dhe të qëndrueshme.

Gjatë javës së studimit pjesëmarrësit do të kenë mundësi të diskutojnë me profesorë dhe ekspertë ndërkombëtarë duke u thelluar në çështje që lidhen me shkaqet thelbësore të konflikteve deri te drejtësia tranzitore, nga roli i institucioneve ndërkombëtare deri te siguria energjetike dhe sfidat gjeopolitike bashkëkohore.

Përveç programit akademik shkolla synon të jetë një ambient dinamik dhe i hapur që nxit shkëmbimin e ideve, përvojave dhe perspektivave mes të rinjve nga vende të ndryshme.

Për më shumë informacion mbi Summer School dhe për të konsultuar materialet e edicioneve të mëparshme, mund të vizitoni faqen zyrtare të Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”: <https://www.unizkm.al/posts/slug/9deg-edizione-della-summer-school-roots-of-war-establishment-of-a-lasting-peace>

Për çdo informacion shtesë, kontaktoni sekretarinë në adresën: cespic@unizkm.al
Regjistrimet mbeten të hapura deri më **10 gusht 2025**.



NËSE DËSHIRONI PAQE, PËRGATISNI INSTITUCIONET E PAQES

Në audiencë me Papa Leoni XIV

Shkova së bashku me Atë Paskalin në audiencën e Papa Leo-s XIV më datë 30 maj. Na u bashkuan rreth 300 përfaqësues të shoqatave dhe lëvizjeve të angazhuara për promovimin e paqes, shkruan fr. Ruggero Valentini Presidenti i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë.

Në Romën e lashtë thuhej “Si vis pacem, para bellum” (nëse do paqe, përgatitu për luftë), por në vend të kësaj Papa gjatë audiencës tha, – “Nëse dëshironi paqe, përgatitni institucionet e paqes. Gjithnjë e më shumë po e kuptojmë se nuk bëhet fjalë vetëm për institucionet politike që vihen në pikëpyetje, por për të gjithë grupin e institucioneve arsimore, ekonomike, sociale”.

Pa dyshim edhe ne si Universitetin Katolik të Tiranës u ndjemë të vënë në pikëpyetje, shkruan fr. Valentini, sepse



universitetet janë vende takimi dhe dialogu midis kulturave, vende ku zhvillohet mendimi kritik dhe racional, si dhe mjete për t'u marrë në konsideratë për ndërtimin e paqes. Mund të rikujtojmë (Konferenca e Rektorëve të Universiteteve Italiane, 19 tetor 2023).

Në rrëmujën e botës së sotme, vendet e vetme të heshtjes krahas vendeve të meditimit fetar mbeten universitetet. Ato janë ende ndër vendet e pakta ku është i mundur një krahasim racional midis botëkuptimeve të ndryshme, shkruante Umberto Eco në fjalimin e tij të vitit 2013 mbajtur në Bolonja, "Why Universities".

Roli shumë i lartë arsimor i Universitetit u nënvizua nga Papa edhe nga perspektiva e luftës kundër dhunës: "Ka shumë dhunë në shoqëritë tona. Fëmijët dhe të rinjtë kanë nevojë për përvoja që i edukojnë ata rreth kulturës së jetës, dialogut dhe respektit të ndërsjellë. Dhe para së gjithash ata kanë nevojë për dëshmitarë të një stili jetese ndryshe, pa dhunë".

Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë lindi me këtë mision dhe nuk është rastësi që së fundmi njoftoi shpalljen e një Çmimi vjetor për Paqen që do të jepet për herë të parë pas disa muajsh. Kjo është një njohje e atyre që në rajonin e Ballkanit janë protagonistë të mendimeve dhe hapave konkretë për paqen.

Çmimi i Paqes i bashkohet në këtë mënyrë një tjetër nismë që filloi në mars të vitit 2024, Kopshtit të të Drejtëve. Janë vetë studentët, lektorët, punonjësit e FZKM protagonistë të zgjedhjes së të Drejtës çdo vit, të cilëve u bashkohen në ditën e votimit të hapur edhe të gjithë ata që janë të pranishëm në kampusin universitar-spitalor. (frRV)




HARMONIA E DALLIMEVE

Vijnë nga
katër kontinente

Komuniteti i At' Montit në Tiranë përbëhet nga dhjetë anëtarë, të cilët janë me prejardhje nga **Argjentina, India, Italia, Nigeria dhe Kameruni.** Për ata që mendojnë se bashkëjetesa vëllazërore është e pamundur, ky komunitet dëshmon të kundërtën. Të ardhur nga katër Kontinente 'Vëllazërit' tanë janë të përfshirë në jetën e Fondacionit me detyra të ndryshme dhe tre prej tyre janë studentë në Fakultetin e Mjekësisë.

At' Monti themeloi në vitin 1857 Komunitetin, i cili më pas do të bëhej nismëtar i Fondacionit 'Zoja e Këshillit të Mirë' në Tiranë. Që prej vitit 1993, Fondacioni është i pranishëm në Shqipëri, fillimisht me Poliklinikën "Atë Monti" në qendër të kryeqytetit, më pas me Universitetin dhe së



fundmi me spitalin. Gjatë këtyre viteve janë hapur gjithashtu Qendra e Rehabilitimit dhe Klinika Stomatologjike.

Një veçori e Komunitetit montian është dinjiteti i barabartë midis anëtarëve laikë dhe priftërinjve. Siç thoshte At' Monti në një frazë nga Rregulli i tij i jetës: 'Sado të jemi të ndryshëm nga kombi dhe krahinat, nga vendi dhe nga raca, asgjë nuk duhet të na ndajë'.

VËLLAZERIA QE PËLQEHET

Ka dal botimi i dytë i një libërthi që rrëfen historinë e Luigji Montit dhe shokëve të tij, djemve të dashuruar pas vëllazërimit. Për këtë arsye, ata u burgosën për dy muaj e gjysmë. Është një histori e vërtetë, rrëfyer nga vëllai Ruggero për të nxjerrë në pah rolin aktiv të të rinjve në ndërtimin e një shoqërie vëllazërore.

Papa Françesku shkruan: "një histori e mirë është në gjendje të kalojë kufijtë e hapësirës dhe kohës" dhe "duke u zhytur në histori, mund të gjejmë motivime heroike për të përballuar sfidat e jetës". Teksti i drejtohet edhe të rriturve, të cilët janë edukatorë të jetës së mirë. Në vitin e dyqindvjetorit të lindjes së At Montit, mund të jetë interesante të rishikojmë jetën e tij të rinisë. Librin do ta gjeni në Bibliotekën e Universitetit. (Editrice Ancora, Milano, korrik 2024, fq. 96, 9 euro).



STUDENTËT: MES GJUMIT DHE ZGJIMIT

Ndonjëherë kur lehdatojmë një kafshë në krah të kundërt me drejtimin e qimeve të saj i shkaktokjmë irritim sepse në fakt, kafsha preferon të lëmohej në drejtimin natyral të qimeve mbi lëkurë. Kjo rubrikë synon të provokojë çdo muaj lexuesit. Nga njëra anë të ngjallë tek ata indinjatë ndaj stileve të papërshtatshme të jetesës dhe nga ana tjetër t'i ftojë ata të ndërmarrin zgjedhje të guximshme. Kësaj here fillojmë me studentët që janë padyshim grupi më i madh në Kampusin tonë ZKM. Bëhet fjalë për mijëra të rinj.

Dihet se kur studentët shprehin shqetësimet e tyre shoqëria është në trazira. Ndryshimet e mëdha të dekadave të fundit i kanë nxjerrë studentët edhe në rrugë për reagime. Dëshmi për këtë është ajo që po ndodh në Serbi muajt e fundit.

PO NË TIRANË, NË SHTËPINË TONË ÇFARË PO NDODH?

Përshtypja e përgjithshme është ajo e një mjedisi të qetë dhe të fokusuar, ashtu siç duhet të jetë tek studimet akademike. Vërehet edhe një lloj somnambulizmi si ai i njerëzve të verbër që enden pa e ditur se ku. "Të kapur" në rrjetin e mediave sociale, lojërave apo telenovelave, shumë studentë vuajnë nga një protagonizëm i bllokuar dhe mbeten komod në stanjacion...

A do të ketë
herët a vonë
një zgjim



PRAKTIKË NË KOMPAÑI MIDIS KULTURËS DHE NATYRËS

Farmacia Aboca

R^ektori **Prof. Palombi** nënshkroi ditët e fundit një marrëveshje me kompaninë farmaceutike "Aboca".

Bëhet fjalë për një marrëveshje që ndihmon studentët tanë të Fakultetit të Farmacisë të kryejnë përvoja trajnimi në kompaninë e njohur që prodhon barna natyrale në Umbria të Italisë. "Aboca" është lider në këtë sektor sepse në vitin 2022 ishte ndër 100 kompanitë me reputacionin më të mirë në




Itali, e para në sektorin farmaceutik. Gjithashtu "Aboca" u bë një "kompani me qëllim social" në vitin 2018 dhe përfaqëson një shembull praktik që arrin të kombinojë objektivat e fitimit me qëllime të përfitimit të përbashkët. Gjatë dhjetë viteve të fundit ka shënuar rritje prej 143% të numrit të punonjësve.

Praktika kualifikuese në "Aboca", e cila zgjat gjashtë muaj përfshin trajnimin në një nga fushat e mëposhtme: kërkim dhe zhvillim produktesh, cilësi, mbikëqyrje mjekësore dhe informacion, komunikim shkencor, marketing dhe fusha të tjera biznesi me interes për praktikantin. Marrëveshja parashikon që studentët e UKZKM të përfitojnë edhe mbështetje logjistike duke nisur nga udhëtimi, akomodimi dhe ushqimi dhe një shumë monetare për shpenzimet ditore.

FJALËT E NJË FARMAKOLOGU TË MADH

Lexues të
rregullt



Në Itali shprehja "lexues të rregullt" i referohet atyre njerëzve që kanë një pasion të madh për leximin: Edhe pse nuk janë të shumtë në numër këta lexues në fakt mbajnë gjallë tregun e librit. Kështu do të jetë edhe në Shqipëri.

Për këta lexues të rafinuar ne rekomandojmë një libër nga Silvio Garattini, një farmakolog i njohur dhe themelues i Institutit Mario Negri në Milano, i cili përveç kërkimit eksperimental kryen edhe kërkime klinike intensive.

Garattini shpjegon se çfarë janë barnat dhe si zhvillohen dhe miratohen ato. Nga "barnat gjenerikë" tek "barnat jetimë", tregohet si të përmirësohet mbrojtja e shëndetit tonë dhe e Sistemit Shëndetësor.

«Një ilaç është një substancë kimike (natyrale ose sintetike) që ka aftësinë të ushtrojë një efekt mbi organizmin në veçanti një efekt mbi simptomat ose shkaqet e sëmundjes, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës, shërimit ose luftës kundër vdekshmërisë», thotë farmakologu.

Rrofshin ilaçet pra! "Por duhet të kemi pak më shumë njohuri rreth drogës", thotë me bindje Prof. Garattini. «Ne i përdorim ilaçet në mënyrë të papërshtatshme sepse reklamato dhe informacionet që marrim kanë tendencë ta medikalizojnë shoqërinë tonë. I gjithë informacioni vjen nga ata që shesin dhe nuk ka informacion të mjaftueshëm dhe të pavarur për të ndihmuar njerëzit të zgjedhin. Shumë herë ilaçi nuk është i nevojshëm, por do të mjaftonte të rregullonim zakonet e jetesës së përditshme».

Libri i botuar nga "Il Mulino" në vitin 2025 është i disponueshëm në Bibliotekën "Fratel Paolo Ruatti" të Universitetit ZKM.



**SILVIO
GARATTINI**

Farmakolog
dhe studiues
italian



STATUJA E AT MONTIT NË PROCES VOTIMI

Modeli
paraprak
i skulptorit
Julian
Muçollari



Më **4 qershor 2025**, në sallën kryesore të Universitetit, u zhvillua një konsultim i hapur për statujën e ardhshme të të Lumit Luigi Maria Monti, e cila do të vendoset në kampusin tonë. U plotësuan 133 fletëvotime, nga të cilat mund të nxirren disa konsiderata interesante.

Në lidhje me përshtypjen e parë nga modeli i statujës, bie në sy një ndjesi e fortë përfshirjeje me veprën e artistit Julian Muçollari, e pasuar nga kureshtja. Vetëm pak pjesëmarrës shprehën ndjenjë largësie apo indiference. Në pyetjen nëse modeli pasqyron mesazhin karizmatik të At Luigi Montit, shumica mendojnë se ai e përshkruan me origjinalitet artistik.

Sipas votuesve, është e drejtë që **figura e At Montit të përfaqësohet në Kampus**, duke u pasuar nga mendimi se ai e meriton dhe na përfaqëson. Vetëm disa e konsiderojnë nismën pa kuptim.

Sa i përket materialeve që do të përdoren për realizimin përfundimtar të statujës, shumica janë shprehur në favor të bronzit, e ndjekur nga guri ose druri. Për vendndodhjen e ardhshme të saj, është preferuar gjerësisht një hapësirë përballë spitalit, e ndjekur nga hyrja kryesore e Universitetit.

Në pyetjen nëse ka gatishmëri për të dhënë një kontribut ekonomik për realizimin e statujës, shumica janë shprehur se duhet ta mendojnë, disa janë të sigurt që do të kontribuojnë, dhe vetëm pak janë shprehur se çështja nuk i përket.



Në fund të takimit, disa të pranishëm dëshiruan t'i shprehnin drejtpërdrejt skulptorit vlerësimet e tyre, duke dhënë gjithashtu këshilla të vlefshme për përmirësimin e veprës.



NGA IDEJA TEK MODELI ARTISTIK

Artisti **Julian Muçollari** tregoi se nga çfarë ishte frymëzuar gjatë modelimit të projektit në baltë. Skulptori punoi për tre muaj mbi idenë fillestare të personazhit dhe u përpoq, siç shpjegoi gjatë prezantimit, të përcjellë përmes skulpturës së tij mesazhin e edukimit, arsimimit dhe kujdesit shëndetësor – vlera që, sipas tij, **mishërohen në figurën e Luigi Montit**. Pedagogë, të ftuar dhe studentë bënë shumë pyetje për skulptorin, i cili, me skicën e tij, ngjalli emocione dhe nxiti ide tek publiku i pranishëm.

TË GJITHË TË NDALUAR, TË GJITHË NË DËGJIM



Publiku ndoqi drejtpërdrejt edhe **Olmo Guagnetti**, i cili foli për librin e tij "Të gjithë në arrest", që rrëfen historinë e At Montit në vitet e tij të rinisë. Guagnetti është një historian tridhjetëvjeçar, i angazhuar shoqërisht, i cili ka hulumtuar një episod të Rilindjes Italiane, ku Luigi Monti ishte protagonist. Libri është botuar nga **shtëpia botuese "Ancora" në Milano**.



FESTIVAL ME HISTORI QË FRYMËZOJNË

Një takim besimi, arti dhe mirënjohjeje në zemër të Tiranës

Më 5 qershor 2025, në parkun "Rinia" në Tiranë u organizua për herë të parë "Festivali i talenteve", që bashkoi qytetarë, drejtues të Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë, Ipeshkvin e Tiranës e Durrësit Mons. Arjan Dodaj, Profesor Salvatore Martinez, si dhe studentë të rinj të UKZKM-së.



Organizimi u shndërrua në një moment feste dhe mirënjohjeje ndaj atyre që vënë në shërbim të gjithëve dhuratat që kanë marrë nga Zoti. Takimi u zhvillua në ambient të hapur. Kjo u duk qartë nga prania e kurioziteti i qytetarëve të ndryshëm që ndoqën këtë iniciativë në Parkun "Rinia", një ngjarje që u organizua në **kuadër të festimeve për dyqindvjetorin e lindjes së Atë Luigji Montit**.



Iniciativa kulmoi me performancën e artistes italiane të Sand Art (artit me rërë), **Stefania Bruno**, e cila vizitoi Shqipërinë për herë të parë. Ajo krijoi skena në kohë reale me rërë, duke rrëfyer ngjarjet njerëzore të Beatos Luigi Montit. Të pranishmit dëgjuan Ipeshkvin e Tiranës e Durrësit, i cili theksoi praninë dhe vlerën e talenteve në kishën lokale. Salvatore Martinez, njohës i thellë i talenteve, thelloi teologjinë e tyre dhe kuptimin për rritjen e gjithë komunitetit social.



Në faqen 15 vijon intervista me Stefania Brunon

TREGU DHE PUNËSIMI

Një Perspektivë
ndërdisciplinare
dhe krahasuese

Italia dhe Shqipëria përballen me sfida të përbashkëta në një treg pune në zhvillim të vazhdueshëm: mungesa e kapitalit njerëzor, emigrimi, shkalla e ulët e lindshmërisë dhe mospërputhja midis formimit dhe punësimit.

Për të gjitha këto tema të ndjeshme u orgaizua në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" konferenca me temë "Tregu dhe Punësimi - Një Perspektivë Ndërdisciplinare dhe Krahasuese", e cila ka si qëllim të nisë dialog konstruktiv midis dy vendeve për të identifikuar zgjidhje të përbashkëta dhe të qëndrueshme. Takimi u krye në bashkëpunim me Ambasadën e Italisë në Tiranë, me AIGA-n (Shoqata Italiane e Avokatëve të Rinj) dhe Confindustria Albania.



Gjatë paneleve diskutuesit sollën me vlerësimet e tyre një pasurim të mëtjeshmëm të panoramës që shohim në kohët e teknologjisë. Presidenti i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë **fr. Ruggero Valentini** tha se sot flasim për një temë që na prek të gjithëve dhe që ne tek Fondazione ZKM e kemi për zemër sepse është një sfidë që e jetojmë dhe duam të shohim të rinjtë të përparojnë.

Po punojmë tha ai, mbi 3 komponentë që janë përballja, rezistenca dhe rikthimi i të rinjve dhe burimeve njerëzore në vendet e tyre.

Sot përballemi me dëshirën e të rinjve për t'u larguar drejt tregjeve më të mëdha ndaj duhet të mendojmë gjetjen e mekanizmave që ata të kthehen, të japin më të mirën sepse kanë bagazhe dijetsh e aftësish që i kanë fituar gjatë studimeve. **Arqipeshkvi i Tiranë**

-Durrësit Monsinor Arjan Dodaj tha se e kishte pranuar me kënaqësi ftesën për këtë takim sepse pavarësisht se çështjet ekonomike nuk janë profili i tij, ai mund të kontribuonte duke dhënë një ide etike rreth zhvillimit të tregut të punës në kohët e sotme.

Është e domosdoshme, tha Monsinor Dodaj, të kuptojmë se punonjësit nuk janë instrumenta, por njerëz që meritojnë dinjitet. Ai solli në vëmendje fjalët e Atit të Shenjtë Papa Leoni për dinjitetin që u duhet dhënë punonjësve për kontributin që japin në ndërtimin e shoqërisë dhe mirëqenies së saj.

Shoqëria është e drejtë, nënvizoi Monsinori, kur puna kthehet në shumatore të mirëqenies së të gjithëve. Papa Leoni, tha ai, na kujton se duhet të ndërtojmë një ekonomi ku në qendër është njeriu.

Presidenti i Confindustria Albania **Davide Rogai** tha se sot flasim për një shoqëri në zhvillim dhe në mënyrë profesionale përpiqemi të krijojmë ekulibra për rritje, për formim akademik dhe një shtrat për të ardhmen.

Rogai tha se sot flasim edhe për Inteligjencën Artificiale dhe sigurisht kjo sipas tij e ndërlikon në një kuptim sipërfaqësor tregun e punës dhe qasjen e punonjësve në të. Për folësit në panelet e konferencës njerëzit e



organizuar, talentet e tyre rrisin shanset për mirëqenie dhe kur këta së bashku formojnë ekipe, kjo është një gjë e mirë për shoqëritë.

Dekani i Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" **Prof. Vittorio Teotonico** tha gjatë ndërhyrjes së tij se punësimi i qëndrueshëm është emancipim shoqëror, politik dhe ekonomik në çdo shoqëri.

Ai shpjegoi se në UKZKM kujdesemi kaq shumë për rritjen akademike të studentëve sepse duam të rrisim aftësinë e tyre profesionale që të përballojnë me sukses tregun e punës gjithmonë në ndryshim.

Puna, tha Prof. Teotonico, duke sjellë në vëmendje gjatë konferencës thënie të lektorëve të mëdhenj botërorë, është e drejtë sociale, ekonomike, ligjore dhe është përcaktuar si e tillë në kushtetutat e vendeve demokratike.

USHQIMI ËSHTË SHËNDET

Formim dhe shkencë për një ushqyerje
të ndërgjegjshme dhe të integruar



Pjesëmarrja e Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” në Kongresin e II-të të Shoqatës Shqiptare të Shkencës së Ushqyerjes (ASNS), nën drejtimin e **Prof. Angela Andreoli**.

Më 24 maj 2025, në Hilton Garden Inn në Tiranë, u zhvillua Kongresi i dytë i Shoqatës Shqiptare të Shkencës së Ushqyerjes (ASNS), me titullin “Nutrition is Health”. **Prof. Leonardo Palombi**, Rectori i Universitetit Katolik, mori pjesë në kongres së bashku me pedagogë të njohur të universitetit, të cilët kontribuan në mënyrë aktive në sesionet tematike me ndërhyrjet e tyre shkencore.

Me këtë pjesëmarrje, Universiteti riafirmon angazhimin e tij për promovimin e kërkimit shkencor dhe formimin ndërdisiplinor në fushën e ushqyerjes, e cila konsiderohet si një shtyllë themelore e shëndetit publik. Kongresi vuri gjithashtu në dukje se bashkëpunimi ndërinstitucional është një levë strategjike për zhvillimin e politikave të integruara në mbështetje të parandalimit dhe shëndetit publik.

NJË DEGË E RE NË SHKODËR

Së bashku për formimin

Dega e re e Qendrës së Formimit Profesional At’ Monti po ngrihet në Shkodër.

Në foto shihni Presidentin **fr. Ruggero Valentini** dhe **don Mark Shtjefni** që shtrëngojnë duart pas nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë dhe Seminarit Ndërdioqezan të Shkodrës.

Në shtator në strukturën e Seminarit do të fillojë programi për Asistentët e Shëndetit Social (OSS) dhe së shpejti ai për teknikët e IT-së.



Me këtë iniciativë Kisha Katolike e vë veten në shërbim të shoqërisë për të zhvilluar iniciativa formimi për punë duke iu përgjigjur nevojës për profesionistë të formuar që tani është bërë e dukshme se mungojnë edhe në Shqipëri. Zgjedhja e emigrimit, e cila është një e drejtë e njeriut sigurisht që nuk përjashtohet. Qendra At’ Monti strukturë e Fondacionit “Zoja e Këshillit të Mirë” punon për të nxitur tek studentët orientimin drejt tre sfidave; Të Rezistosh, Të Qëndrosh, Të Kthehesh.

PROJEKTE SUKSESI

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" në ballë të inovacionit për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe shëndetin onkologjik.

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" ka kënaqësinë të ndajë me komunitetin akademik dhe publikun lajmin e përzgjedhjes për financim të dy projekteve kombëtare për kërkim e zhvillim, të udhëhequra nga **Dr. Andia Guga**, Departamenti i Arkitekturës dhe **Dr. Elisa Domi**, Departamenti për Vlerësimin Kimiko-Toksikologjik dhe Farmakologjik të Barnave, në kuadër të thirrjes së Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI). Projekti "Monitorimi strukturor i Teatrit të Akademisë së Arteve Tiranë: teknologji inovative për ruajtjen e trashëgimisë kulturore shqiptare" është një iniciativë novatore që sjell për herë të parë në Shqipëri teknologji të avancuar



për monitorimin e strukturave historike. Projekti synon zhvillimin dhe implementimin e një sistemi të monitorimit të vazhdueshëm mbi Teatrin e Akademisë së Arteve, për të regjistruar në mënyrë të detajuar sjelljen e strukturës si në kushte të zakonshme (degradim natyror), ashtu edhe në situata të jashtëzakonshme (tërmete). Në

këtë nismë marrin pjesë edhe partnerë të rëndësishëm ndërkombëtarë si: Universiteti i Firences, TECNOPOLO D'ABRUZZO, PALMERINI SCT, WEST AQUILA SRL dhe MGAD DESIGN.

Ky bashkëpunim shumëdisiplinor do të mundësojë krijimin e modeleve të replikueshme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, duke kombinuar shkencat inxhinierike me inovacionin digjital dhe arkitekturën historike.

Projekti "Roli i mikotoksinave në pacientët onkologjikë", përfaqëson një kërkim të rëndësishëm që adreson lidhjen midis pranisë së mikotoksinave në organizëm dhe simptomave neuropsikiatrike tek pacientët me kancer. Në mungesë të të dhënave kombëtare për këtë çështje, ky projekt do të realizojë për herë të parë në Shqipëri një studim sistematik mbi llojet dhe efektet e mikotoksinave tek pacientët onkologjikë, në bashkëpunim me QSUT, Universitetin e Barit "Aldo Moro" dhe qendrat kërkimore italiane CNR e ISPA. Ky projekt do të kontribuojë në përmirësimin e të kuptuarit të ndikimit të mikotoksinave në shëndetin mendor të pacientëve, si dhe në përcaktimin e politikave të reja shëndetësore dhe sociale për këtë kategori të ndjeshme. Këto projekte janë një dëshmi e angazhimit të vazhdueshëm të Universitetit tonë në përparimin e kërkimit shkencor në nivel kombëtar, si dhe në forcimin e bashkëpunimit me qendra e partnerë vendas dhe të huaj.



WORKSHOP

Dialog mbi shërbimet publike dhe institucionet



Nga data 29 deri më 30 maj 2025 u zhvillua workshop-i i projektit TNE-DeSK me titull "Local Public Service Provision and Quality of Institutions" i organizuar në bashkëpunim mes Departamentit të Ekonomisë të Universitetit të Chieti-Pescara dhe Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit "Zoja e Këshillit të Mirë" të Tiranës. Ky aktivitet paraqiti një mundësi të rëndësishme për shkëmbim akademik dhe profesional.

Morën pjesë tre pedagogët e UKZKM **Prof. Klodian Muco**, **PhD Blerina Metanaj** dhe **PhD Bardhe Karra**, së bashku me studentët e vitit të tretë të programit Bachelor në Ekonomi Ndërmarrjeje dhe të Programit Master të Shkencave në Ekonomi dhe Menaxhim.

Punimet u zhvilluan në katër ditë të mbushura me seminare, prezantime punimesh, diskutime dhe aktivitete laboratorike. Iniciativa nxiti dialogun ndërmjet institucioneve universitare mbi tema kyçe për zhvillimin e aktiviteteve të ardhshme.



NDËRTESTA BANIMI DHE HAPËSIRË PUBLIKE

Takimi i dytë mbi arkitekturën italiane



Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” organizon Talks@UNIZKM_2025, një seri konferencash ndërkombëtare kushtuar arkitekturës bashkëkohore italiane, me qëllim promovimin e një debati kritik dhe ndërdisiplinor.

Takimi i dytë u zhvillua më 4 qershor 2025 në një nga sallat e Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”.

Në këtë takim mori pjesë arkitekti dhe profesori i Universitetit të Ferrarës, **prof. Gabriele Lelli**, i cili foli rreth temës me titull “Rezidencat dhe hapësirat publike”. Referimin e ndoqën dhjetra studentë të Arkitekturës në UKZKM, të cilët paten mundësi të kuptojnë për mënyrat se si godinat e banimit mund të ndërveprojnë me hapësirën publike duke u shndërruar në elementë aktivë në ndërtimin e qyteteve më gjithëpërfshirëse, më të jetueshme dhe më të përbashkëta. Takimi solli nëpërmjet referimeve profesionale eksperiencën e vyer të Italisë në këtë aspekt.

Ky aktivitet ishte pjesë e Javës Kulturore të Italisë në bashkëpunim me Ambasadën Italiane në Tiranë dhe Institutin Italian të Kulturës.



NJË PRAKTIKË SOLIDARE

Praktikë dhe
mbështetje
për shoqërinë

Studentët e Vitit të 6-të në Odontoiatri dhe Protezë Dentare kryen praktikën e fundit akademike duke dhënë ndihmë edhe ndaj njerëzve që kanë nevojë për mbështetjen e shoqërisë.

Gjatë praktikës profesionale studentët e UKZKM bashkëpunuan me Organizatën jofitimprurëse “Vizioni” duke përforcuar aftësitë e tyre praktike, por edhe duke kontribuar njëkohësisht në rritjen e edukimit oral për brezat e rinj.

Studentët kryen me sukses procesin diagnostik dhe procedurat profilaktike për ruajtjen e shëndetit oral për 12 fëmijë nga zona e Rrëshenit.



Gjatë vitit akademik studentët e UKZKM në programin e studimit Odontoiatri dhe Protezë Dentare kryejnë shpesh një proces të tillë praktik që rrit kapacitetet e tyre mjekësore në shërbim të njerëzve dhe komuniteteve. Gjatë ciklit profesional u zbatuan leksionet e dhëna gjatë lëndës së pedodoncisë.



NJË KLINIKË PËR TË GJITHË

Në ofrojmë asistencë për grupet që kanë shumë pak mundësi për të pasur akses në kujdesin dentar, thotë **Dr. Françeska Vinjolli**, Dentiste, Specialiste në Ortodonci dhe Drejtore Teknike. Çdo vit, sipas saj, realizohen bashkëpunime të qëndrueshme me organizata dhe shoqata të ndryshme, me qëllimin që ky shërbim të mos kufizohet vetëm në aspektin klinik, por të jetë i orientuar edhe drejt mbështetjes së grupeve që kanë më pak akses në shërbimet dentare private.

Gjatë vitit akademik, në kuadër të praktikës profesionale, studentët angazhohen në ofrimin e një gamë të gjerë shërbimesh dentare, përfshirë: diagnostikën, pastrimin profesional të tartarit, trajtime restauruese (mbushje), rehabilitime protetike (protezë e pjesshme dhe totale), kirurgji orale, si dhe shërbime specialistike në odontologjinë pediatrike.

Të gjitha këto ndërhyrje kryhen nën mbikëqyrjen e stafit akademik dhe janë të destinuara për zhvillimin profesional të studentëve të vitit të fundit. Për Dr. Françeska Vinjolli, ky angazhim jo vetëm forcon kompetencat klinike dhe praktike të studentëve të vitit të fundit, por përbën edhe një akt konkret solidariteti dhe përgjegjësie sociale, duke kontribuar në përmirësimin e shëndetit oral të personave dhe komuniteteve në nevojë.

Stomatologji dhe solidaritet shoqëror



SHKËMBIME NË TOR VERGATA

Përvoja të përbashkëta dhe energji të reja

Erasmus +



Në periudhën nga data 12 deri më 16 maj 2025, në kuadër të projektit Erasmus+, specifikisht të Mobilitetit Nderkombëtar të stafit akademik dhe administrativ, **Dr. Prunela Poliçi** dhe **Klarita Marga** u pritën nga Fakulteti i Mjekësisë së Universitetit të Romës Tor Vergata me qëllim shkëmbimin e përvojës me këtë realitet evropian. Institucioni pritës kishte organizuar një axhendë me aktivitete të ndryshme akademike dhe administrative në Fakultetin e Mjekësisë. Dr. Poliçi mbajti një cikël leksionesh në modulën e Propedeutikës Klinike në kuadër të Kursit të Integruar të Principeve të Stomatologjisë. Klarita Marga zhvilloi takime me stafin e Sekretarise Didaktike dhe atë të Studenteve. Përvoja e bashkëndarë midis dy realiteteve mundëson njohjen me mekanizma të rinj që mund të përdoren dhe zbatohen në punën e përditshme me nxënësit dhe pedagogët.

Me këtë rast ata patën mundësinë të integrohen në kontekstin e ri akademik, të njihen me figura të ndryshme të rëndësishme akademike dhe administrative që i përkasin Fakultetit të Universitetit, të krahasojnë dhe shkëmbejnë strategji për aktivitetet e ndryshme kërkimore dhe të krijojnë njohuri dhe perspektiva të reja për bashkëpunimet e ardhshme si dhe promovimin e diversitetit kulturor.

PËRTEJ DETIT...

Erasmus +

Shkëmbim përvojash
dhe praktikash të mira



Nga datat **12 deri më 16 maj 2025** **Erjola Bej**, koordinatorë e Fakultetit të Farmacisë pranë Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", njëkohësisht anëtare e Departamentit për Vlerësimin Kimiko-Toksikologjik dhe Farmakologjik të Barnave zhvilloi një vizitë trajnimi në Universitetin "Carlo Bo" të Urbino-s në kuadër të projektit të Lëvizshmërisë së stafit mbështetur nga programi Erasmus+ KA171.

Përmes këtij mobiliteti u nxit shkëmbimi i përvojave, praktikave dhe politikave institucionale në fushën e edukimit farmaceutik dhe përmirësimi i kapaciteteve profesionale duke kontribuar në objektivin e përbashkët për përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë dhe integrimin në kontekstin evropian të kërkimit dhe mësimdhënies.

...MIDIS TIRANËS DHE URBINOS

Integrimi midis
farmakologjisë,
ushqyerjes
dhe gjenezës
për të përballuar sfidat
e shëndetit publik

Si pjesë e mobilitetit të stafit Erasmus+ KA171 ndërmjet Universitetit të Urbino Carlo Bo dhe Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" nga data 19 deri më **23 maj 2025** **PhD Bianka Hoxha** mbajti një cikël leksionesh në Fakultetin e Farmacisë – Departamenti i Shkencave Biomolekulare.

Ligjërata e saj u përqendrua në fushat kryesore tematike duke përfshirë ndikimin e folatit në zhvillimin neurologjik dhe gjendjet neurodegenerative duke iu referuar çrregullimeve të spektrit të autizmit dhe rolit të metabolizmit të lipideve në rrezikun kardiovaskular, të trajtuar përmes perspektivave të avancuara biokimike dhe klinike të sesionit të të ushqyerit apo gjenetikës.

Inkurajimi i studentëve për të lidhur mekanizmat molekularë me ndikime më të gjera klinike, teknikat e mësimdhënies ndërvepruese, skenarët klinikë dhe strategjitë krahasuese të shëndetit publik u përdorën për të stimuluar angazhimin e studentëve dhe për të mbështetur zbatimin praktik të njohurive teorike të tyre.



Gjatë vizitës PhD Bianka Hoxha pati mundësinë të takonte Pr. Daniela Ligi ekspertiza e të cilës i shërbeu shkëmbimit akademik të nevojshëm për të ndërtuar përvoja më të integruara. Diskutimi mes dy profesoreshave u përqendrua tek rëndësia e lidhjes së farmakologjisë, të ushqyerit dhe gjenetikës në mënyra që rezonojnë me sfidat e shëndetit publik në botën reale.

PËRBALLJA ME REZISTENCËN NDAJ ANTIBIOTIKËVE

Një temë shumë aktuale



Prof. Asc. Silvi Bozo, Drejtuese e Departamentit të Teknologjive Kimike-Farmaceutike dhe Biomolekulare në Fakultetin e Farmacisë, mori pjesë në programin e mobilitetit të stafit për mesimdhënie (nën Erasmus+), në Universitetin e Parmës, nga 26 deri më 30 maj 2025. Gjatë këtij shkëmbimi akademik, ajo ndau ekspertizën e saj me studentët e doktoraturës në Shkencat e Barnave, si dhe me studentë nga Fakulteti i Farmacisë, duke mbajtur leksione mbi çështje kyçe që kanë të

bëjnë me përdorimin e antibiotikëve. Sesionet e saj eksploruan trendet kritike globale dhe lokale në konsumin e antibiotikëve, hodhën dritë mbi sfidat e reja në këtë fushë dhe u përqendruan në çështjen në rritje të rezistencës ndaj antibiotikëve, veçanërisht në kontekstin e epokës COVID-19, e cila nxori në pah boshllëqe të konsiderueshme në administrimin e antibiotikëve në mbarë botën. Përveç mesimdhënies së saj, Prof. Bozo zhvilloi takime konstruktive me anëtarët e fakultetit pritës Ilaria Zanotti, Fabio Sonvico dhe Elisabetta Barocelli, duke diskutuar mundësitë për bashkëpunim akademik në të ardhmen dhe nisma të përbashkëta kërkimore mbi përdorimin dhe rezistencën ndaj antibiotikëve. Në rolin e saj si Koordinatorë Akademike Erasmus, Prof. Bozo shprehu gjithashtu një angazhim të fortë për të promovuar mundësitë e ardhshme të mobilitetit të studentëve, duke synuar forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit midis institucioneve.

Ky mobilitet mesimdhënieje Erasmus nënvizon përkushtimin e vazhdueshëm të Fakultetit të Farmacisë për të nxitur shkëmbimin shkencor dhe për të promovuar partneritetet ndërkombëtare në shkencat farmaceutike dhe biomjekësore.

AKADEMIKË TË GJITHË BOTËS, BASHKOHUNI!

Java
Ndërkombëtare
në Sevilje

Në kuadër të mobilitetit ndërkombëtar të stafit për trajnim, nën programin Erasmus+, **Prof. Elona Mehilli**, Pedagoge e Gjuhës dhe Kultures Angleze, mori pjesë në Javën Ndërkombëtare të stafit të zhvilluar në Universitetin e Seviljes, Spanjë, gjatë datave **19-23 maj 2025**. Ky event bashkoi akademikë nga e gjithë bota për të nxitur shkëmbimin kulturor, bashkëpunimin akademik, administrativ dhe zhvillimin personal. Aktivitetet u fokusuan në ndërkombëtarizimin e universiteteve dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta. Përmes seminareve dhe trajnimeve, ky event kontribuoi në ndërtimin e lidhjeve ndërkombëtare dhe promovimin e kërkimit shkencor dhe arsimit cilësor.



Gjatë kësaj jave, mbi 160 profesionistë dhe akademikë nga vende të ndryshme të botës morën pjesë, duke përfshirë Anglinë, Gjermaninë, Italinë, Greqinë, Estoninë, Letoninë, Lituaninë, Ukrainën, Gjeorgjinë, Turqinë, Afrikën e Jugut, Hungarinë, Holandën, Portugalinë dhe shumë vende të tjera.

SEKRETI I IMAZHEVE ME RËRË

INTERVISTË ME STEFANIA BRUNON

Sand artist



SI U NDJETË NË TIRANË DHE NGA PRITJA E DREJTUESVE TË FONDACIONIT ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË?

Nuk kisha qenë kurrë më parë në Tiranë, duhet të them se pritja me të cilën më uruan mirëseardhjen, më emocionoi dhe më bën të dëshiroj rikthimin. Më bëri përshtypje moderniteti i qytetit të Tiranës dhe efikasiteti i Kampusit Universitar Zoja e Këshillit të Mirë. Mirëseardhje, miqësi, buzëqeshje të sinqerta, FZKM na priti mua dhe vëllain tim si të ishim nga një familje. Dua të kthehem!

HISTORIA QË TREGOVE ME KRIJIMIN E FIGURAVE NË RËRË ISHTË E BUKUR. SA KOHË TË DUHET PËR T'U PËRGATITUR PARA SE TË SHKOSH NË PREZANTIM? SI IA DEL TË KUJTOSH KAQ MIRË GJATË KRIJIMIT ARTISTIK RRADHËN E FIGURAVE PA HARRUAR GJË?

Çdo histori për t'u treguar meriton përgatitje serioze, si një mozaik, ku secila pjesë krijon një imazh të plotë me kalimin e kohës. Ka shumë punë pas asaj që ju ndoqët në shfaqje. Duhet "t'i qepësh" skenat sipas muzikës dhe të përpiqesh t'u japësh një ritëm të caktuar që shpesh kthehet në luftë me kohën dhe vëmendjen e publikut. Le të themi se për rreth dhjetë ditë krijojmë një shfaqje, kjo falë edhe bashkëpunimit të çmuar të vëllait tim.

CILI ËSHTË SEKRETI I PËRBËRËSVE TË RËRËS QË PËRDOR?

"Sekreti" i rërës sime konsiston në dashurinë e madhe që i kushtoj asaj ndërsa e krijoj me materialet e duhura. Ndonjëherë mendoj se kokrrizat e rërës më binden gjatë kohës që luaj dhe krijoj me to.



JU JENI E NJOHUR NË MBARË BOTËN. A MUND TË TREGOSH SE CILA ËSHTË HISTORIA MË E VËSHTIRË QË TË ËSHTË DASHUR TË PREZANTOSH PARA PUBLIKUT?

Ndër historitë më të vështira për t'u treguar është ajo e vitit 2016 kur Parlamenti Evropian në Bruksel na besoi përmes teknikës së rërës rikrijimin e një projekti bashkëpunimi midis kombeve të ndryshme. Ishte një punë që ndërthuri artin me idetë e natyrës politike dhe ndërkombëtare. Kujtoj që ishte një sfidë e vështirë, por na dha kënaqësi të madhe kur doli me sukses dhe u mirëprit nga publiku.

A DO TË KTHEHESHE PËRSËRI NË SHQIPËRI?

Shpresoj të kthehem në Shqipëri. Më bëri përshtypje gadishmëria e njerëzve për të na ndihmuar, dashamirësia ndaj italianëve, pothuajse të gjithë e kuptojnë italishten, shumë e flasin dhe une e ndjeva se u pritja me mirësi. Pastaj mësova edhe disa fjali nga shqipja, më bëri përshtypje "Faleminderit!" që është më shumë sesa një falënderim i thjeshtë. Po ashtu fjalia "Të lumshin duart!". Nuk di si ta shkruaj saktësisht, por do të doja t'a shkruaja sespe ka të bëjë me duart... me instrumentat e mi.



REFLEKTIM MBI NJË AKT FISNIKËRIE

Dhurimi i Një Pasurie
Librash për Bibliotekën
"Fr. Paolo Ruatti"



nga Mimoza Agastra

Përgjegjëse e Bibliotekës "Fr. Paolo Ruatti" pranë UKZKM

Epoka digjitale që ka trokitur prej kohësh mes nesh, duket sikur po konkuron ndjeshëm dhe sfidon librat fizikë që qëndrojnë heshtazi nëpër raftet "në grahamat e fundit" të përdorimit nga lexues gjithnjë e më të paktë në numër. Është koha kur brezi i ri më shumë se kurrë po konfuzohet se çdo të ndodhë nesër me librin fizik.

Pikërisht në këtë përballje të shoqërisë me sfidën e dilemës së kohës, vjen si një shpresë ky akt, se libri do të mbetet një antiquar dhe vlerë transmetuese nga brezi në brez për fuqinë e tij zotëruese. Ai do të vazhdojë të ruhet e të konservohet me fanatizëm prej atij kontigjenti i cili është ende i dashuruar me kontaktin fizik me të, duke e shfletuar me duar e duke i ndjerë aromën e mbetur nga vitet.

Lumturisht e gëzuar dua të ndaj me ju një xhest fisnik, ardhur nga **një ish-mësuese, Lena Caka**, e cila ka qenë e përkushtuar pas një karriere të gjatë në arsim dhe pas një jete të lidhur ngushtë me librin.

Sot ajo për arsye familjare, për të vazhduar misionin e saj edukativ, tashmë përmes rritjes së nipërve e mbesave të saj me profesionin e ri si "Gjyshe", rrugëton jashtë Shqipërisë, por e rritur mes dijes, leximit, investimit shpirtëror në pasurimin e vetes përmes librave që janë pjesë e pasurisë së saj, vendos dhe zgjedh Bibliotekën e Universitetit tonë të jetë "streha e re" e prehjes së një copëze të saj të shpirtit, pasi **"Çdo libër i harruar mban një shpirt që dikur foli me zjarr"**. Ajo si një edukatore

e transmetuese e dijes nuk mund të ishte e qetë nëse e vetmja e saj pasuri "të digjej apo të hidhej", kështu trokiti gjetur në derën e duhur për tu bërë pjesë dinjitoze në një bibliotekë që pasurohet dita-ditës, jo vetëm me tekste akademike por edhe me arsenale shpirtërore të dhuruesve të ndryshëm që janë rritur me librin dhe e konsiderojnë atë aq të çmuar në një karrierë sidomos akademike.

Ajo zgjodhi të dhurojë koleksionin e saj personal të librave, të cilën ajo e konsideron si një memorie të çmuar të mbledhur ndër vite me përkujdesje dhe pasion të thellë për dijen pasurisë së Bibliotekës sonë.

Kjo mësuese, e njohur për kontributin e saj të palodhur në edukimin e shumë brezave, nuk e ka parë librin thjesht si një objekt, por si një dritare drejt botës, një mjet për të frymëzuar, për të menduar dhe për të ndërtuar ura midis brezave. Koleksioni i saj përfshin libra të rrallë, vepra klasike e bashkëkohore, tekste pedagogjike, letërsi shqipe dhe të huaj, si dhe tituj që reflektojnë zhvillimet në fushat e shkencave shoqërore, gjuhësisë, historisë dhe edukimit.

Ky akt bujar dhe thellësisht simbolik është më shumë sesa një dhuratë fizike. Ai është një trashëgimi kulturore dhe shpirtërore që i dorëzohet bibliotekës dhe studentëve, ndaj në emër të përdoruesve të Bibliotekës sonë, falenderuese për donacionin e mbështetjen e dhënë për pasurimin e fondit tonë bibliotekar si një dëshmi e ndjeshmërisë suaj ndaj dijes, kulturës dhe brezave të rinj që rriten me dashurinë për librin.

Ky veprim fisnik ndihmon në zhvillimin dhe promovimin e leximit, edukimit të trasmetimit të pasurisë intelektuale brez pas brezi.

THONË PËR NE...

Punimet e **Kongresit të Dhjetë të DILLE** (Agjensisë Italiane të Mësimdhënies dhe Gjuhësisë Arsimore) që u mbajt për tre ditë në Aula Magna në Kampusin Universitar ZKM në Tiranë sollin një kontribut të vyer të ekspertëve që japin sot panorama të dobishme për komunikimin publik cilësor. Tema të shumta me interes të lartë u prekën gjatë katër ditëve të punimeve plenare, duke sjellë në vëmendje çështje si territoret dhe gjuha, ndikimi i dygjuhësisë në kontekstet e sotme evropiane dhe më gjerë, trashëgimia gjuhësore, kultura e mbrojtjes linguistike, pasurimi dhe diversiteti gjuhësor, ndikimi i teknologjisë, didaktika dhe nxënja e studentëve, ekuilibri social dhe teknologjia etj.

Kontribues në këtë kongres ishin profesorë të njohur nga **Universitetet e Bolonjës, Maltës, nga Bolzano, Padova etj.** Duke risjellë falenderimin për lëtë organizim profesional rikujtojmë fjalët e mirëseardhjes së **Prof. Natalina Hoti Drejtoreshë e Qendrës Universitare të Gjuhëve "Zoja e Këshillit të Mirë"** se çdo gjuhë është një kufi që bashkon dhe nuk ndan.



Redaktori: Sonila Agostini
Faqesja dhe grafika: Fredi Dragusha (grafplus) ZKMPress

TAKIMET E ARDHSHME

UNIVERSITÄ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

#architettura

Professionista per un giorno

27 giugno 2025

11:00

Università Cattolica NSBC, Tirana

UNIVERSITÄ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

#fisioterapia

Professionista per un giorno

4 luglio 2025

11:00

Università Cattolica NSBC, Tirana

UNIVERSITÄ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

#infermiera

Professionista per un giorno

4 luglio 2025

11:00

Università Cattolica NSBC, Tirana

UNIVERSITÄ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

#economia

Professionista per un giorno

1 luglio 2025

11:00

Università Cattolica NSBC, Tirana

UNIVERSITÄ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

#farmacia

Professionista per un giorno

1 luglio 2025

11:00

Università Cattolica NSBC, Tirana

3 LUGLIO
22 LUGLIO



LIVE

INSTAGRAM



UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO



UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

Laurea in Economia

23 luglio 2025

Aula Magna, UCNSBC - Tirana

Nuovo libro



ZKM
PRESS

Le copie del libro si trovano
in Biblioteca "Fratel Paolo Ruatti"
presso all'Università Cattolica
NSBC, Tirana